



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:034959
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05737250

E.nr.810/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në lëndën përmbartimore të kreditorit Xh.Xh. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av Nezir Bytyqi nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizaj – Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit, shpërblimit jubilar dhe shpenzimet e procedurës, më datë 27.05.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.794/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.793/23, të datës 17.05.2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit, shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.508/20, të datës 24.11.2020.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 03.10.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,158.12 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.810/23, më datë 27.05.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi